

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "Wild Ways" Sh.p.k.

Sot, më datë 13/04/2023,

- **Znj. Vilma Vorpsi**, shtetase shqiptare, lindur me 23/06/1983, ne Tirane, banuese ne Tirane, mbajtese e dokumentit karte identiteti me nr. personal I35623073U, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Wild Ways**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Wild Ways" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga e Dibrës, Banesë Private Nr.261/1, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.


NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Operator turistik, organizim udhëtimesh individuale ose në grupe për shtetas shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit;
- Promovimi i turizmit në Shqipëri dhe jashtë saj;
- Transport turistik tokësor, shitje biletash të transportit kombëtar e ndërkombëtar urban, hekurudhor, ajror e detar;
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash dhe pasagjerësh për vete dhe për të tretët etj.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike



shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Vilma Vorpsi**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Znj. Vilma Vorpsi, shtetase shqiptare, lindur më 23/06/1983, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me nr. personal I35623073U, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratoren Znj. Vilma Vorpsi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

VILMA VORPSI

